

SELEKSIONI SEKSUAL TE NJERIU: PËRTHYERJE ANTROPOLOGJIKE (REVIEW)

ANI BAJRAMI.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Qendra Kërkimore e
Florës dhe Faunës

e-mail: ani.bajrami@fshn.edu.al

Përmbledhje

Mekanizmi i seleksionit seksual u propozua prej Darvinit në vitin 1859 dhe është përgjegjës për formimin e tipareve dhe sjelljeve që i ndihmojnë organizmat të riprodhohen dhe të lënë pasardhës. Krahas problemeve të mbijetesës, organizmat përballen me problemet e riprodhimit, të lidhura ngushtë me lënien e pasardhësve dhe kujdesin prindëror. Te njeriu, femrat janë seksi më përzgjedhës. Gjatë evolucionit të njeriut, kultura si produkt evolucionar ose si formë e përshtatjes së njeriut me mjedisin natyror dhe atë social, ndikoi në formësimin e tipareve të parapëlqyera gjatë zgjedhjes për partner. Zgjedhjet për partner janë shprehje e tipareve specifike që zotëron një sistem i caktuar sociokulturor. Tiparet e preferueshme përcaktohen dhe transmetohen socialisht si dhe janë të lidhura me kontekstin ku zhvillohet zgjedhja e partnerit dhe e partneres. Evolucioni kulturor i tipareve të preferueshme për partner dhe partnere seksuale ndryshon në kohë, riorganizohet si informacion në varësi të kontekstit ku ndodh zgjedhja dhe ka natyrë përshtatëse. Nga ky këndvështrim, seleksioni seksual nuk mund të shpjegojë plotësisht repertorin e shumëllojshëm të sjelljeve që shfaqen të njeriu në lidhje me zgjedhjen dhe tiparet e preferuara për partnerë seksualë (Laland 2017).

Fjalëkyçe: Seleksion seksual, evolucioni i njeriut, problemet e riprodhimit, investimi prindëror, kultura.

Abstract

The mechanism of sexual selection was first proposed by Darwin in 1859. This evolutionary mechanism is responsible for traits and behaviors which helps organisms reproduce and leave descendants. Alongside survival problems, organisms face reproductive problems which are related to offspring and parental investment for the future generations to come. In humans, female are more choosy. During human evolution, culture as an evolutionary product *alias* ways of adapting to both natural and social environment shaped preferences for both male and female partners and the desirable traits associated. Mate choice and mate preferences are deeply influenced by cultural traits regarding mating in a certain socio-cultural system. The preferred features are socially transmitted and context-related or dependable on other cultural variables when mate choice happens. Cultural evolution of desirable traits in a sexual partner change over time and the information embedded on those traits reorganize continually and it is context dependent. Furthermore, it has an adaptive nature. In this context, sexual selection alone can not fully explain human behaviors regarding mate choice and desirable traits for a future sexual partner (Laland 2017).

Key words: sexual selection, human evolution, reproductive problems, parental investment, culture

Hyrje

Seleksioni seksual u propozua prej Darvinit në veprën e tij “ Prejardhja e llojeve” të botuar për herë të parë në vitin 1859. Ai është një nga format e seleksionit natyror që favorizon ato tipare dhe sjellje që lidhen me lënien e pasardhësve (Puts, 2015). Seleksioni seksual, krahas atij natyror që zgjidh problemin adaptiv të mbijetesës, zgjidh problemin adaptiv të riprodhimit. Në mënyrë të zgjeruar, problemet e riprodhimit dhe prindësisë u trajtuan nga Fisher-i (1930), Bateman-it (1948) dhe Trivers-i (1972). Sipas teorisë së Fisherit, një tipar tërheqës merr rëndësi për aq kohë sa ai rrit mundësinë e të vegjëlve për të mbijetuar. Për shembull, një shpend mashkull me pupla të bukura dhe të mirëmbajtura është tërheqës për femrën pasi tregon jo vetëm aftësi të mira fluturimi por edhe mundësi për t'i mbajtur puplat në formë të mirë përmes kryerjes së proceseve të pastrimit (Qirjo 2004). Në vijim, u identifikuan përbërësit para dhe pas riprodhues të këtij tip seleksioni si sjellja agresive, zgjedhja për partner apo konflikti seksual (Andersson & Simons, 2006). Seleksioni seksual vepron nëpërmjet dy proceseve: seleksioni intraseksual dhe seleksioni interseksual. Seleksioni intraseksual vepron gjatë konkurrencës së ashpër për partnere seksuale, mes të njëjtit seks. Në këtë proces përzgjedhës, vetëm disa tipare dhe sjellje marrin përparësi, krahas sjelljeve dhe tipareve që gjenden në individët me seks të njëjtë (Buss, 2015). Në ndryshim nga ky tip seleksioni, seleksioni interseksual vepron gjatë zgjedhjes për partnere seksuale. Ai njihet ndryshe dhe si “zgjedhja e femrave”. Vlen të theksohet se seleksioni ka dy karakteristika kryesore: ai vepron në nivelin e individit ose të grupit dhe ka një produkt që lidhet me formimin e tipareve anatomike dhe sjelljeve me natyrë përshtatëse (Mayr, 2001).

Në kohën kur Darvini propozoi teorinë e evolucionit me anë të seleksionit natyror, kundërshtarët e tij nuk e pranuan si model shpjegues por sintheza e kësaj teorie me gjenetikën në shekullin XX, i dhanë vendin që meriton asaj (Gribbin, 2002). Në vijim, teoria e evolucionit me anë të seleksionit natyror u integrua plotësisht dhe shërbeu si themel i biologjisë moderne (Dobzhansky, 1973). Natyrshëm, seleksioni seksual u përdor si mekanizëm shpjegues i formimit të tipareve dhe sjelljeve që lidheshin me sjelljet riprodhuese dhe prindërore. Si përmendëm, formulimi i teorisë së investimit prindëror (Trivers, 1972) ishte rezultat i punimeve të mëparshme të R. Fisherit që formuloi teorinë e seleksionit fisherian (1930). Kjo teori ka në qendër mendimin se tiparet dhe sjelljet seksuale e vërejtura ndër organizma, janë shprehje e preferencës së femrave gjatë evolucionit. Në këtë mënyrë, pasardhësit e këtyre femrave, do të kenë tiparet e nënave të tyre ose do të shfaqin të njëjtat parapëlqime si nënat e tyre, kur i përkasin seksit femër. Ky tip seleksioni është përgjegjës dhe për krijimin e variacioneve të vërejtura në lidhje me zgjedhjen e problemit të riprodhimit (Pomiankowski & Iwasa, 1988).

Sakaq, në mesin e shekullit XX, u formulua teoria e historisë së jetës. Kjo teori paraqet strategjitë që përdorin organizmat në lidhje me zgjidhjen e problemit të mbijetesës dhe riprodhimit përgjatë jetës. Si pohuam, integrimi i teorisë së seleksionit seksual në shpjegimin e sjelljeve prindërore i detyrohet pothuajse plotësisht Trivers-it. Teoria e investimit prindëror përmban dy pohime të rëndësishme: së pari, seksi që investon më shumë do të jetë më përzgjedhës në lidhje me partnerin ose partneren seksuale dhe së dyti, seksi më pak përzgjedhës, do të konkurrojë agresivisht për zotërimin e seksit tjetër (Trivers, 1972). Gjithashtu, hipoteza principi i handikapit, parashikon se një tipar zburues seksual ose sjellje, megjithëse i kushtueshëm në termat e fitnesit për zotëruesin e saj, mundëson sigurimin e partneres dhe ndihmon në lëniën e pasardhësve (Zahavi, 1975). Gjithashtu, me kalimin e kohës, si pasojë e veprimit të këtij tip seleksioni do të shfaqet dimorfizmi seksual (Clifton *et al.*, 2016). Si vëmë re me lehtësi, këto teori janë në përputhje dhe zgjatim i teorisë së seleksionit interseksual të propozuar dikur prej Darvinit.

Nga ana tjetër, Wilson-i u përpoq të sintetizonte zhvillimet kyçe të biologjisë evolutive dhe të shpjegonte arsyen e shfaqjes së sjelljeve të tilla si altruizmi dhe agresiviteti (1975). Mbartësit e këtyre sjelljeve kishin sukses më të madh riprodhues në krahasim me të tjerët dhe kjo shpjegonte arsyen e shfaqjes dhe prezencës së këtyre sjelljeve në një popullatë. Shpjegimet sociobiologjike mbi agresivitetin u përqafuan pjesërisht dhe në konceptet antropologjike (Chagnon, Cronk & Irons, 2000). Kështu, Chagnon-i doli në përfundimin se në shoqërinë Yanomamo, që jeton në pyjet e Amazonës, meshkujt me sjellje agresive janë më të preferueshëm për femrat dhe lënë më shumë pasardhës. E thënë shkurt, agresiviteti ndër meshkuj ishte produkt i zgjedhjes femërore. Por për disa biologë, objekt i veprimit të seleksionit nuk duhej konsideruar individi por gjenet.

Prej këtej, pasardhësit e një lloji u konsideruan “makina transportuese” të gjeneve të prindërve të tyre dhe tashmë gjeni por dhe memi u pa si njësi e veprimit të seleksionit (Dawkins 1976; Blackmore, 1999). Në mënyrë përplotësuese me konceptin e “gjenit egoist” të Dawkins-it, u formulua dhe hipoteza e gjeneve të mira (Hamilton & Zuk, 1982). Kjo hipotezë shpjegon se tiparet e përzgjedhura prej femrave janë shprehje e aftësisë së saj për të pikasur në mënyrë të tërthortë, praninë e gjeneve të mira ose të shëndetshme tek një mashkull. Fill pas punimeve të Wilson-it, zhvillimet teorike në biologjinë evolutive u përdorën për të kuptuar përshtatjet psikologjike që hasen te njeriu. Konkretisht, u pranua se mendja është produkt i evolucionit, e formësuar prej veprimit të tipeve të ndryshme të seleksionit si dhe ajo përbëhet prej moduleve me funksion të veçantë (Fodor, 1983).

Në këtë mënyrë, u realizua sinteza e biologjisë evolutive me psikologjinë konjitive. Pohimi i dikurshëm se mendja e njeriut formësohet prej mjedisit dhe përbëhet nga njësi funksionale me funksion të përgjithshëm u hodh poshtë (Barkow, Cosmides & Tooby, 1992). Shpjegimi i tipareve dhe sjelljeve të njeriut të formuara gjatë evolucionit, duke përdorur teorinë

darwiniane të seleksionit së bashku me konceptin e modularitetit, shërbeu si bazë për formulimin e mekanizmave të evoluuar psikologjikë (Buss, 2008). Këto mekanizma u formuan gjatë evolucionit biologjik e kulturor të njeriut dhe përfaqësojnë përshtatje që zgjidhën dikur problemet e ndryshme adaptive. Te njeriu, tipet e seleksionit biologjik hedhin dritë mbi një repertor të gjerë sjelljesh, jehonë e të kaluarës së tij evolutive.

Veprimi i seleksionit te njeriu

Seleksioni natyror është përgjegjës për formësimin e përshtatjeve me natyrë fiziologjike, morfologjike dhe sjelljeve (Lenski, 2017). Seleksioni seksual, si formë e seleksionit natyror, por që zgjidh problemin e riprodhimit, formon tipare dhe sjellje me natyrë përshtatëse (Bajrami, 2015). Ndër organizma, dimorfizmi seksual dhe tiparet zbukuruese, me qëllim përfitim të partnerit si p.sh prania e dhëmbit të zhvilluar kanë te primatët apo rritualet riprodhuese që vërehen ndër organizma, janë shembuj të përshtatjeve të formuara si pasojë e veprimit të seleksionit seksual (Andersson, 1994).

Te njeriu, ndryshimet mes mashkullit dhe femrës shfaqen në parapëlqimet e tyre mbi partneren ose partnerin seksual. Femrat e sotme, kanë trashëguar tipare dhe sjellje që i ndihmojnë ato të zgjedhin partnerin e duhur seksual. Gjatë evolucionit, meshkujt e përzgjedhur prej këtyre femrave, gëzonin cilësi të përputhshme me preferencat e femrave zgjedhëse. Ndër veçoritë kryesore që duhet të gëzonin meshkujt për lidhje afatgjata, ishte të pasurit resurse të mjaftueshme dhe fizik të mirë (Buss, 1989; Conroy-Beam *et al.*, 2015). Për femrën, resurset si dhe perspektiva ekonomike e partnerit janë të lidhura ngushtë me sigurimin e ardhmërisë së fëmijës. Pasja e këtyre karakteristikave, zgjidh një problem të rëndësishëm adaptiv, atë të mbijetesës. Nga ana tjetër, po të përdorim gjuhën e Zahavit, fiziku i mirë është shfaqje e tërthortë e pranisë së gjeneve të mira. Qartazi, meshkujt mbipeshë dhe obezë nuk janë të preferueshëm prej femrave (Carr *et al.*, 2013).

Nga ana tjetër, parapëlqimet e meshkujve për femrat janë shprehje e veprimit të seleksionit seksual gjatë evolucionit seksual të njeriut. Parapëlqimi kryesor i meshkujve në lidhjet afatgjata janë femrat më të reja në moshë (Buss & Schmitt 1993). Ky tipar zgjidh një problem të rëndësishëm për meshkujt, lënien e pasardhësve të shëndetshëm. Si kuptohet, femrat dhe meshkujt kanë zgjedhur strategji të ndryshme seksuale si dhe gëzojnë mekanizma të dallueshëm psikologjikë për të zgjedhur problemet adaptive. Këto strategji ose zgjidhje evolutive ndaj probleme adaptive ndryshojnë pasi investimi prindëror është i ndryshëm mes sekseve por parapëlqimet mbeten pothuajse të njëjta pavarësisht ndryshimeve sociale që ndikojnë në lëkundshmërinë e tyre (Bech-Sorensen & Pollet 2016). Ndryshimet biologjike dhe të sjelljes janë jehonë e historisë së ndryshme evolutive ose mënyrës së ndryshme të zgjidhjes së problemeve adaptive dhe rrjedhimisht, hasen edhe të mekanizmat psikologjikë që qëndrojnë në bazë të mendjes së njeriut të sotëm. Lind pyetja: Cili është ndikimi i kulturës në këto

ndryshime dhe si ka ndikuar ajo në formësimin e tipareve dhe sjelljeve seksuale të meshkujve dhe të femrave?

Seleksioni kulturor

Përshtatja më e rëndësishme e njeriut është aftësia e tij për të prodhuar kulturë. Transmetimi social i sjelljeve të mësuara realizohet sidomos me anë të gjuhës simbolike, që shërben si ruajtëse dhe përcjellëse e informacionit kulturor (Messoudi 2017). Mbi këtë informacion, vepron seleksioni kulturor, i cili i jep përparësi atyre tipareve, me anën e të cilave, individët zgjidhin problemet adaptive. Në këtë mënyrë, formohen përshtatjet kulturore. Në ndryshim nga tipet e seleksionit biologjik, seleksioni kulturor vepron mbi njësitë e kulturës a.k.a tiparet kulturore, që ndryshojnë dhe riorganizohen vazhdimisht nga ana informacionale.

Tiparet kulturore, ku përfshihen dhe preferencat për partner ndryshojnë ose pësojnë evolucion. Evolucioni kulturor apo transmetimi i tipareve të mësuara gjatë jetës nuk kufizohet vetëm me njeriun por haset rëndom edhe ndër organizmat e tjerë (Whiten *et al.*, 2017). Si theksuam, ndryshimi themelor qëndron në përdorimin e komunikimit simbolik për transmetimin e kulturës nga një brez në tjetrin.

Përfundime

Preferencat dhe zgjedhjet për partner janë shprehje e tipareve kulturore që zotëron një sistem i caktuar socio-kulturor. Tiparet e preferueshme përcaktohen dhe transmetohen socialisht ku një rol të madh luan gjuha simbolike. Vlen të theksohet se preferencat për partner janë të lidhura me kontekstin ku zhvillohet ngjarja përzgjedhëse. Ai ndryshon vazhdimisht dhe tiparet e preferueshme për partner dhe partnere seksuale ndryshojnë po ashtu në kohë duke u riorganizuar si informacion, për t'iu përgjigjur kontekstit kulturor ku ndodh ngjarja përzgjedhëse. Këto zgjedhje kanë natyrë përshtatëse pasi janë të lidhura ngushtë me informacionin e ekstraktuar prej mjedisit (Rendell *et al.*, 2011). Ato nuk mund të shpjegohen plotësisht si produkt i veprimit të seleksionit seksual. Një tip tjetër seleksioni, ai kulturor, është përgjegjës për formësimin e tipareve kulturore që lidhen me preferencat dhe zgjedhjet për partner.

Literatura

Andersson, M. (1994): *Sexual selection*. Princeton, NJ: Princeton University Press

Andersson M., Simmons L.W. (2006): *Sexual selection and mate choice*. *Trends in Ecology and Evolution*, 21 (6): 296–302

Bajrami, A. (2015): *Antropologjia: Një perspektivë biokulturore*. Tiranë: Shtëpia Botuese Albdesign

Barkow, J., Cosmides, L., & Tooby, J. (1992): *The adapted mind: Evolutionary psychology and the generation of culture*. New York: Oxford University Press

- Bateman, A. J. (1948): Intrasexual selection in *Drosophila*. *Heredity*, 2 (pt 3): 349-368
- Bech-Sorensen, J., & Pollet, V. Th. (2016): Sex differences in mate preferences: A replication study, 20 years later. *Evolutionary Psychological Science*, 2 (3), 171-176
- Blackmore, S. (1999): *The meme machine*. New York: Oxford University Press
- Buss, D. (2015): *The handbook of evolutionary psychology*. Volume 1: Foundation. Second Edition. New Jersey: Wiley
- Buss, D. (2008): *Evolutionary Psychology: The new science of mind*. New Jersey: Wiley
- Buss, D. M., & Schmitt, D. P. (1993): Sexual strategies theory: an evolutionary perspective on human mating. *Psychological Review*, 100 (2), 204–232
- Buss D. (1989): Sex differences in human mate preferences: Evolutionary hypothesis tested in 37 cultures. *Behavioral and Brain Sciences*. 12 (1): 1–49
- Carr, D., Murphy, L. F., Batson, H.D., & Springer, K.W. (2013): Bigger is not always better: The effect of obesity on sexual satisfaction and behavior of adult men in US. *Men and Masculinities*, 16 (4): 452- 477
- Chagnon, N. A., Cronk, L., Irons, W. (2000): *Adaptation and Human Behavior: An Anthropological Perspective*. Routledge Publishing
- Clifton, S. M., Braun, R. I. &, Abrams, D.M. (2016): Handicap principle implies emergence of dimorphic ornaments. *Proceedings Biological Sciences*, 283 (1843). pii: 20161970
- Conroy-Beam, D., Goetz, C. D., & Buss, D. M. (2015): Why do humans form long-term mateships? An evolutionary game-theoretical model. *Advances in Experimental Social Psychology*, 51: 1-39
- Dawkins, R.(1976): *The selfish gene*. New York: Oxford University Press
- Dobzhansky, Th. (1973): Nothing in Biology Makes Sense Except in the Light of Evolution. *American Biology Teacher*. 35: 125–129
- Fisher, R. A. (1930): *The genetical theory of natural selection*. Oxford: Clarendon Press
- Fodor, J. (1983): *The modularity of mind*. Cambridge, MA: MIT Press
- Gribbin, J. (2002): *Science: A history 1543-2001*. UK, London: Penguin Press
- Lenski, R.E. (2017): What is adaptation by natural selection? Perspectives of an experimental microbiologist. *PLoS Genetics*, 13, 4: e1006668
- Hamilton, W. D., & Zuk, M. (1982): Heritable true fitness and bright birds: a role for parasites? *Science*, 218, 384-387
- Mayr, E. (2001): *What evolution is*. New York: Basic Books

- Messoudi, A. (2017). Pursuing Darwin's curious parallel: Prospect for a science of cultural evolution. *Proceedings of the National Academy of Sciences, USA*, 114: 7853-7860
- Pomiankowski, A., & Iwasa, Y. (1988): Runaway ornament diversity caused by Fisherian sexual selection. *Proceedings of the National Academy of Sciences USA*, 95: 5106-5111
- Qirjo, M. (2004). *Etologjia: Sjellja e kafshëve*. Tiranë: Shtëpia Botuese Julvin
- Rendell, L., Boyd, R., Enquist, M., et al. (2011): How copying affects the amount, evenness and persistence of cultural knowledge: insights from the social learning strategies tournament. *Philosophical Transactions of the Royal Society*, 366: 1118-1128
- Zahavi A. (1975): Mate selection – selection for a handicap. *Journal of Theoretical Biology*, 53, 205–214
- Whiten, A., Ayala, F. J., Feldman, M. W., & Laland, K. (2017): The extension of biology through culture. *Proceedings of the National Academy of Sciences, USA*, 114: 7775-7781
- Wilson, E. O. (1975): *Sociobiology: The new synthesis*. Cambridge, MA: Harvard University Press